

**MBI**  
**AUDITIMIN E USHTRUAR NË**  
**KOMUNËN SHËNKOLL, LEZHË**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Komunën Shënkoll, Lezhë**, me objekt: *“Mbi vlerësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, aktivitetit ekonomik e financiar, prokurimet me fondet publike, taksat dhe tarifat vendore, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve e lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit, administrimin e asetëve, dhënien me qira të objekteve pronë publike, etj”*, lloji i auditimit: *“Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare”*, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2012 deri 31.12.2013 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 36, datë 18.04.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 *“Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”*, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, date 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 1079/7, datë 18.4.2014, i ka rekomanduar z. Fran Frroku Kryetar i Komunës, zbatimin e masave të mëposhtme:

**A. MASA ORGANIZATIVE.**

1. Komuna Shënkoll të zbatojë rekomandimet e mëparshme sipas shkresës nr.185/5, datë 24.10.2008 dhe aktverifikimit nr.1, datë 16.01.2009 të KLSH për vlerën **2,407,850 leke**, për 4 subjekte juridike si *“M...”* shpk për vlerën 175,421 leke, subjekti *“Laska”* shpk për 132,614 leke, subjekti *“L...”* 1,517,221 leke, shpk *“A...”* 94,060 leke dhe për 6 persona tjerë për vlerën 488,534 leke.

2. Të paraqitet para Këshillit të Komunës për miratim Rregullorja e funksionimit të brendshëm të administratës së Komunës në bazë të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 *“Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”* të ndryshuar neni 32 pika (a).

**Menjëherë**

3. Nga Komuna Shënkoll, të merren masa që të plotësohen dosjet e personelit administrativ me dokumentacionin e domosdoshëm të munguar sipas rastit si dhe të bëhet në të gjitha rastet noterizimi i tyre në përputhje me VKM nr. 355, datë 07.07.2000 *“Për organizimin e dosjes dhe Regjistrin të Personelit”* të përcaktuar në Aneksin I dhe II.

**Menjëherë**

4. Nga zyra e taksave vendore në bashkëpunim me Zyrën e Financës të bëhet programimi i të ardhurave në bazë të një përlllogaritje të detajuar për çdo lloj të tyre, mbi bazë reale, pasi për përlllogaritjen e tyre nuk janë shfrytëzuar të gjithë elementët e bazës së të dhënave si dhe në mundësitë dhe resurset e kësaj njësie vendore në bazë të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 *“Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”* dhe ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 *“Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”* të ndryshuar neni 19 pika (a).

**Vazhdimisht**

5. Nga Zyra e Financës të merren masa që derdhja dhe arkëtimi i të ardhurave nga taksat vendore e tjera të bëhet nëpërmjet bankës në përputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”* pika 61,63,64 dhe 65.

**Vazhdimisht**

6. Zyra e Financës për të krijuar një sistem mbrojtës kundrejt humbjeve dhe dëmtimeve për aktivet afatgjata dhe afatshkurta përballë aksesit të përdorimit të marrë masa për hapjen e kartelave personale për secilin punonjës për inventarin ekonomik dhe objektet e inventarit të

tërhequr nga magazina, në bazë të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 60.

#### **Menjëherë**

**7.** Nga Zyra e Financës të bëhen azhurnimet e përditësuara deri në momentin aktual të librit inventar me të dhënat e aktiveve të trupëzuara që në krijimin e tyre, domosdoshmëri kjo për të patur një evidentim dhe pasqyrë të plotë në mënyrë analitike të aktiveve në përputhje me gjendjet në llogaritë e bilancit në përputhje me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, VKM nr.783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël” dhe Kap. III-<sup>të</sup> të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

#### **Vazhdimisht**

**8.** Nga ana e Zyrës së taksave të Komunës Shënkoll, në bazë të ligjit nr.9631, datë 30.02.2006 “Për sistemin e taksave vendore” ndryshuar neni 4 pika 7 dhe ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore” të ndryshuar të merren masa për krijimin e regjistrit manual edhe elektronike të subjekteve që mbartin detyrimin :

-të **taksës tokës**, për arkëtimin e detyrimeve të pa likuiduara të 2057 familjeve debitore deri më datën 31.12.2013 në vlerën **21,482,000 lekë**.

-të **taksës banesave**, për arkëtimin e detyrimeve të palikujduara të 2905 familje në vlerën **5,574,000 lekë**.

-të **taksës pastrimit**, për arkëtimin e detyrimeve të palikujduara të 1909 familjeve në vlerën **8,590,500 lekë**.

#### **Deri më 31.8.2014**

**9.** Komuna Shënkoll të marrë masat për arkëtimin e detyrimit në shumën **916,500 lekë** të 11 subjekteve që ushtrojnë aktivitet të pa licencuara, në të kundërt tu vendosen gjobë në masën 25.000 lekë, sipas nenit 112 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore”, dhe tu mbyllet aktiviteti dhe në rast mosarkëtimi nga ana e tyre e detyrimit të kryhet konfiskimi i materialeve në përputhje me ligjin nr. 9632, datë 31.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” dhe ligjin nr. 9920, datë 10.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSh” neni 41.

#### **Menjëherë**

**10.** Komuna Shënkoll të marrë masat për arkëtimin e detyrimit në shumën **520,000 lekë** të 9 subjekteve që ushtrojnë aktivitet sezonal në periudhën e verës në të kundërt tu vendosen gjobë, sipas nenit 112 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore”, dhe tu mbyllet aktiviteti dhe në rast mosarkëtimi nga ana e tyre e detyrimit të kryhet konfiskimi i materialeve në përputhje me ligjin nr. 9632, datë 31.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” dhe ligjin nr. 9920, datë 10.05.2008 “Për Procedurat Tatimore” neni 41.

#### **Deri më 30.8.2014**

**11.** Nga Komuna të merren masa që për 19 subjektet të cilat nuk kanë paguar detyrimet për vlerën **4,505,500 lekë**, meqenëse nga Bankat kanë kthyer përgjigje negative për urdhrat e bllokimit të llogarive, të ndiqen procedurat ligjore e përmbarimore deri në kallëzim penal në zbatim të nenit 131 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, i ndryshuar, pikës 130-132 të udhëzimit Ministrisë Financave nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore”, i ndryshuar dhe ligjit dhe Kodit Penal i R.SH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet neni 181, -Mospagimi i taksave dhe tatimeve.

#### **Menjëherë**

**12.** Nga ana e zyrës së taksave dhe policisë Komunare të hartohet paketa me llojet dhe masën e gjobës dhe t’i propozohet këshillit të komunës, të vendosë për çdo shkelje të cilat përbëjnë kundërvajtje administrative, siç përcaktohet në shkronjën (a) të ligjit nr. 10.279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 6 “Shkeljet që përbëjnë kundërvajtje administrative.

### **Menjëherë**

**13.** Nga Zyra e taksave të dërgohen në Zyrën e Financës, përfundimin e 3 viteve 2011, 2012 dhe 2013, lista e debitorëve për detyrimet fiskale me qëllim regjistrimin si debitorë, llogaritjen e kamat vonesave dhe ndjekjen ligjore të tyre.

### **Menjëherë**

**14.** Nga Komuna të merren masa që në organogramën që do ti propozohet për miratim në Këshillin e komunës të parashikohet një strukturë e veçantë për administrimin, inventarizimin, gjendjes faktike dhe mbledhjen e të ardhurave nga kontratat e qirave të aseteve në administrim të Komunës, në zbatim të VKM nr. 500, datë 14.8.2001 “*Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin në njësitë e qeverisjes vendore*”, pika 9.

### **Menjëherë**

**15.** Nga komuna të merren masa për ngritjen e një komisioni të posaçëm për kryerjen e inventarizimit fizik dhe hartimin e planvendosjeve për secilën nga pronat e përfshira në listën dhe të miratuara paraprakisht me VKM nr. 194, datë 06.03.2013 “*Për Miratimin e Listës Paraprake të Pronave të Paluajtshme Publike, Shtetërore, që Transferohen, në Pronësi ose në Përdorim të Komunës Shënkoll të Qarkut të Lezhë*” në bazë ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*” dhe me Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*”.

### **Menjëherë**

**16.** Zyra e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokave në komunë të marrë masa që në bashkëpunim me AKKP, SAMT në Këshillin e Qarkut dhe ZVRPP Lezhë, të saktësojë pronat shtet dhe ato private, të shoqëruar këto me hartat përkatëse dhe pasi të pasqyrojë ato elektronikisht e topografikisht, të mbajë një kopje të dokumenteve në Arkivin e Komunës në zbatim të ligjit nr. 9154 datë 06.11.2033 “*Për Arkivat*”i ndryshuar.

### **Menjëherë dhe vazhdimisht**

**17.** Nga Komuna të bashkëpunohet me Drejtorinë e Shërbimit Pyjor të Ministrisë të Mjedisit që për pronat fond pyjor dhe kullosor që i transferohen Komunës në bazë të VKM nr.803, datë 4.6.2008, të përcaktohen kategoritë,të merren hartat përkatëse, ku të përcaktohen kufijtë dhe planvendosjet e tyre.

### **Menjëherë**

**18.** Zyra e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës dhe Zyra e Tatim Taksave në bashkëpunim me Policinë e Komunës dhe INUV të marrë masa për mosvazhdimin e përdorimit të paligjshëm dhe shfrytëzimin e pasurive truall në pronësi të kësaj Komune, (prona të ish–Kooperativës Bujqësore dhe ish ndërmarrjeve), troje për ndërtime banesash e përdorime ngrehinash kryesisht nga banorët, zaptim i truallit për kultivime bujqësore pa pasur marrëdhënie ligjore (*pronësie a qiraje*) lidhur me tokën me qëllim vënien e tyre në efikasitet për sigurim të ardhurash, si dhe të krijohet korrespondencë me ALUIZNI-n për saktësimin e pronave që janë në proces legalizimi.

### **Menjëherë dhe vazhdimisht**

**19.** Nga Zyra e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban, për çdo rast të shqyrtohen dhe të paraqiten për miratim vetëm ato kërkesa për sheshe dhe leje ndërtimi të cilat janë të shoqëruara me dokumentin e pronësisë (*vërtetim pronësie ose certifikatë pronësie e shoqëruar me hartën treguese dhe kartelën e pasurisë së paluajtshme*) të rifreskuar, brenda muajit të fundit. Për çdo rast të shqyrtohen dhe të paraqiten për miratim vetëm ato kërkesa për sheshe dhe leje ndërtimi të cilat kanë të plotësuar formularët 1, 3 dhe 3/1 dhe që janë brenda afateve ligjore për shqyrtim.

### **Vazhdimisht**

**20.** Nga Zyra e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban, për çdo rast dhe për çdo vendim të zbatohet procedura e administrimit me protokoll të dokumentacionit që zbardhin vendimet dhe

kërkesat për leje sheshi dhe leje ndërtimi, duke qenë transparent me afatet dhe procedurat që kryhen.

#### **Vazhdimisht**

**21.** Nga Zyra e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban të mos pranohet dhe të mos shqyrtohet kërkesa për leje shfrytëzimi, për vendimet e KRRT-së respektive, pa u plotësuar më parë me dokumentacionin e konstatuar që mungon në dosje. Të mos pranohet dhe të mos shqyrtohet kërkesa për leje shfrytëzimi për subjektet ndërtuese dhe investitorët, pa pasur më parë një vërtetim nga zyra e financës, që të vërtetojë shlyerjen e të gjitha detyrimeve financiare.

#### **Vazhdimisht**

**22.** Zyra e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban të regjistrojnë të dhëna përkatëse, duke krijuar regjistrin manual dhe elektronik të planifikimit të territorit, për territorin që administrojnë, sipas kërkesave të ligjit nr.10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”.

#### **Vazhdimisht**

**23.** Zyra e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban të ushtrojë vazhdimisht kompetencat në lidhje me kontrollin e zhvillimit për zbatimin e instrumenteve të planifikimit dhe të marrin masat përkatëse për të shmangur shkeljet mjedisore dhe abuzimet me territorin.

#### **Vazhdimisht**

**24.** Zyra e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban të rrisë bashkëpunimin me strukturat e tjera brenda komunës dhe me autoritetet tjera të planifikimit të çdo niveli duke shkëmbyer informacion për gjendjen e planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit.

#### **Vazhdimisht**

**25.** Drejtoria e financës të bëjë hyrje mallrat për 3 raste për vlerën **1,093,000 lekë**, përkatësisht sipas urdhër shpenzimit nr. 54, datë 27.3.2013 për 1 Banak për vlerën **468,000 lekë**, urdhër shpenzimit nr. 38, datë 23.02.2011 për 1 projekt rruga Rrilë për vlerën **235,000 leke** dhe urdhër shpenzimit nr. 6, datë 15.01.2013 për 3 projekte puse uji për vlerën **390,000 lekë (3x130,000)**, te cilat disponohen ne komune por nuk janë bere hyrje, në kundërshtim me kërkesat e nenit 37 te udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

#### **Menjëherë**

**26.** Të merren masa për arkëtimin e 6 gjobave të vendosura nga INUV për vlerën **2,100,000 lekë** të ardhura të munguara për buxhetin e komunës. Nga Komuna tu kërkohet kundravajtësve të shlyejnë vlerën respektive të detyrimit, me qëllim përmbushjen e detyrimit ligjor.

#### **Brenda datës 31.8. 2014**

**27.** Komuna Shënkoll, të largoje nga skema e ndihmës ekonomike për mungesë dokumentacioni përfituesit e dosjeve nr.707, 708, 721, 735, 624 dhe 711, si dhe të rivlerësohen të gjithë përfituesit, duke evidentuar ata, të cilët paraqiten me mangësi në dokumentacion, duke ju kërkuar plotësimi i dosjeve respektive ose përjashtuar ata të cilët nuk plotësojnë dokumentet.

#### **Menjëherë**

**28.** Komuna Shënkoll të përlogarit penalitetet në masën 4/1000 , për vonesën ne përfundimit te punimeve për objektin *ndërtim ujësjellësi fshati Shënkoll*, ne zbatim te nenit 17 te kontratës date 4.11.2009 lidhur ndërmjet Komunës Shënkoll dhe subjektit A... *Shkodër*.

#### **Menjëherë**

**29.** Komuna Shënkoll, bazuar në nenin 13, pika 3/ç, te ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe udhëzimin e KM, nr. 01, datë 10.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit publik” i ndryshuar. KREU i VIII, pika 2/a “Mbikëqyrja e Kontratës”, **t’i kërkojë** Agjencisë së Prokurimit Publik, **përjashtimin e Kontraktorit “A...Shkodër”, nga pjesëmarrja në prokurimet publike për një periudhë 1 vjeçare.** Pasi nga Operatori ekonomik A...Shkodër, nuk është përmbushur detyrimi për përfundimin në afat të objektit “Ndërtim i ujësjellësit fshati

Shënkoll”, sipas kontratës datë 04.11.2009, lidhur ndërmjet Komunës Shënkoll dhe subjektit “A...Shkodër”.

**Menjehere**

**B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:**

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, kreu I, nenet 105-109 dhe udhëzimin e Ministrit të Financave, nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kap IV, -Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, **nga ana e titullarit të njësisë publike** (Nëpunësit Autorizues), të nxirren aktet administrative, me qëllim kërkimin për shpërblimin të vlerës 18,765,462 lekë, nga kjo **17,447,462 lekë dëm ekonomik** dhe **1,318,000 leke mungese te ardhurash**, si më poshtë:

**1. Vlera 12,513,700 leke**, nga subjekti *A...Shkodër*, sa përfituar për punimeve te pakryera, për ndërtimin e ujësjellësit Shënkoll, sipas kontratës date 4.11.2009.

**Deri më 30.8.2014**

**2. Vlera 830,700 leke**, nga subjekti “L..”, sa përfituar tepër për vitin 2011, sipas urdhër shpenzimeve nr.111, date 12.7.2011, nr.135, date 17.8.2011, nr.147, date 14.9.2011, nr.172, date 23.11.2011, nr.19, date 16.02.2012 dhe nr.37, date 19.3.2012, gjithsej vlera e likuiduar 5,764,920 leke nga vlera e kontratës 4,934,220 leke qe duhej, pra diferenca 830,680 leke, ne kundërshtim me kontratën e pastrimit date 3.6.2011 (3.6.2011-3.6.2012), me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe me udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve në njësitë sektorit publik”.

**Deri me date 30.7.2014**

**3. Vlera 675,000 lekë**, nga subjekti “A...Shkodër”, sa përfituar tepër TVSH për “Makineri dhe Pajisje” ne objektin Ujësjellësi Shënkoll, pasi është marre 2 herë, duke u llogaritur me gjithë vlerën e TVSH, në mospërputhje me UKM nr.2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, nuk është ndarë veças vlera e “montimit” të pajisjeve pa tvsh dhe veças vlera e “pajisjeve” me gjithë vlerën e tvsh, sipas urdhër shpenzimit nr. 119, datë 3.9.2012.

**Deri me date 30.7.2014**

**4.-Vlera 2,373,190 leke**, për diferenca te pa paguara për taksen e ndikimit infrastrukturës dhe kamatëvonesa për **14 subjekte**, në kundërshtim me nenin 51 paragrafi i dyte të ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” i ndryshuar dhe me piken 4 të Vendimit nr. 84, datë 30.12.2010 ‘Për miratimin Taksave e Tarifave Vendore për 2011”.

**Deri me date 30.7.2014**

**5. Vlera 396,000 lekë**, shpenzim i pajustificuar, për riparimin radhazi për periudhën e auditimit të 20 kompjuterave të Komunës, pasi shpenzimi i riparimit ka kaluar kufirin ligjor mbi 25 % te vlerës fillestare në masën e vlerës fillestare tyre, nuk saktësohet viti i blerjes dhe arsytet e difektimit, mungon procesverbali i specialistit të fushës, ne kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” si dhe me udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, për komisionin blerjeve vogla dhe titullarin e komunës, me nga **146,000 leke secili**.

**Deri me date 30.7.2014**

**6. Vlera 400,000 lekë**, sipas urdhër shpenzimit nr. 100, datë 14.6.2011 me procedure te drejtpërdrejte është shpenzuar padrejtësisht shërbimi i pastrimit te plazhit për një subjekt tjetër, pasi pastrimi i plazhit mbulohet nga subjekti “L...”, shpk sipas kontratës date 3.6.2011, ne kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” ndryshuar, me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, me udhëzimin e Agjencisë Prokurimit Publik nr. 02, datë 18.02.2008 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, për 7 persona, përkatësisht: nga supervizori i komunës F.D, kryetari i komunës F.F, komisionin blerjeve vogla A.A., T. M., B.P., M.P. dhe M.Gj. per vleren 57,143 leke seicili.

**Deri me date 30.7.2014**

**7. Vlera 135,872 lekë**, përkatësisht P.P. 9,152 leke, F.L. 105,600 lekë dhe T.P. 21,120 leke, qe bën fjale për 772 litra karburant tejkalm normative, ne kundërshtim me Vendimin e Këshillit Komunës nr.75, date 30.12.2011 dhe nr. 47, date 27.12.2012, me UMF nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

**Deri me date 30.7.2014**

**8. Vlera 123,000 lekë**, përfitim të kundraligjshëm të ndihmës ekonomike, në kundërshtim me kërkesat e pikës 14, të VKM nr. 787, datë 14.12.2005 “Për përcaktimin e kriterëve të procedurave dhe masës së ndihmës ekonomike”, nga për 6 përfitues, përkatësisht Z.V. 24,000 leke, D.L. 17,000 leke, A.L. 17,000 leke, V.T. 17,000 leke, A.C. 20,000 leke dhe P.M. 28,000 leke.

**Deri me date 30.7.2014**

**9. Komuna Shënkoll te marre masa:**

- për arkëtimin e **vlerës 178,000 leke mungese te ardhurash**, për detyrime taksave vendore për vitin 2011 dhe 2012 ose 89,000 leke/vit, përkatësisht takse ndërtese 20,000 leke, tarife pastrimi 30,000 leke, takse tabele 27,000 leke, tjera 12,000 leke, për Kompaninë “A...”, në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

-për arkëtimin e **vlerës 1,140,000 leke mungese te ardhurash**, për subjektin P.Gj., për mos arkëtim detyrime taksave vendore për vitin 2011,2012 dhe 2013, sipas shkresës se komunës Shënkoll nr.69/5, date 8.02,2013, për vlerësimin tatimor te 3 viteve drejtuar subjektit, në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

**Menjëherë**

### **C. MASA DISIPLINORE**

Mbështetur në nenin 144 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës” i ndryshuar dhe nenin 10 të kontratës individuale të punës, kërkojmë që bazuar në nenin 44 të ligjit nr. 8652 datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, kryetari i komunës Shënkoll të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore për **13 punonjësit**, si më poshtë:

**a. “Vërejtje me paralajmerim”**, bazuar ne nenin 10/3 shkronja c të kontratës individuale të punës për 5 punonjës, sa vijon:

**1. F.D.**, me detyrë **juriste**, ne cilësinë e kryetares se njësisë prokurimit, për këto shkelje:

-Për kualifikimin dhe shpalljen fitues te padrejte te operatorit ekonomik “L...” pa efekte financiare, ne kushtet kur subjekti rezulton debitore sipas shkresës nr. 185/5, date 24.10.2008 te

KLSH-se, ne kundërshtim me kriteret e pranimit/kualifikimit ne tender, në kundërshtim me VKM nr.1 datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu VII, “Kushte të përgjithshme për zbatim”, pika 1, “Mungesa e konkurrencës”, germa “a”.

- Ka lejuar emërimin e 2 policëve komunar, në kushtet e mungesës së formimit në Akademinë e Policisë, mungesës se kualifikimit tyre dhe moslidhjes së kontratës 3 vjeçare, në kundërshtim urdhrin e përbashkët të Ministrisë Pushtetit Vendor dhe Ministrisë Rendit Publik nr. 1530, datë 7.4.2003 dhe nr. 823, datë 11.04.2003 dhe Rregulloren TIP dalë në zbatim të saj, me ligjin nr. 8224, datë 15.5.1997 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës”, me ndryshimet e miratuara me nenin 7 te ligjit nr. 8335, datë 23.04.1998, neni 5, Rregulloren e brendshme “TIP” të policisë së Bashkisë dhe Komunës, të miratuar me urdhrin e përbashkët të dy Ministrive, neni 11 “Përzgjedhja e kandidatëve, formimi dhe kualifikimi”, pika 1.

-Për mos aplikim sanksionesh dhe për mos ndërprerje të kontratës ndaj firmës kontraktuese, për vonesat prej 3 vjet, në ndërtimin e ujësjellësit Shënkoll, pasi objekti nuk ka mbaruar punimet, veprim ne kundërshtim me nenin 21 dhe 4 te kontratës date 4.11.2009 i cili përcakton afatin e përfundimit objektit 60 dite nga dita e lidhjes kontratës.

**2. M.P.**, me detyrë **llogaritare**, ne cilësinë dhe te anëtares te KVO, për këto shkelje:

-Për kualifikimin dhe shpalljen fitues te padrejte te operatorit ekonomik “L...” pa efekte financiare, ne kushtet kur subjekti rezulton debitore sipas shkresës nr. 185/5, date 24.10.2008 te KLSH-se, në kundërshtim me kriteret e pranimit/kualifikimit ne tender, në kundërshtim me VKM nr.1 datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu VII, “Kushte të përgjithshme për zbatim”, pika 1, “Mungesa e konkurrencës”, germa “a” si dhe me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” ndryshuar, neni 24/1.

-Për mangësi ne 6 raste ne blerjet e vogla pasi mungojnë specifikimet teknike, ne kundërshtim me udhëzimin e Agjencisë Prokurimit Publik nr. 02, datë 18.02.2008 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”.

- Për lejimin e derdhjes dhe arkëtimit të ardhurave nga taksat vendore e tjera nëpërmjet arkës ne vend te bankës, në mospërputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 61,63,64 dhe 65.

**3. Gj.B.**, me detyrë **Përgjegjëse Zyrës së Menaxhimit të Tokave**, për shkeljet e mëposhtme:

-Për mos kryerje inventarizimi në terren të pronave sipas listës paraprake te miratuar, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

-Për mos përgatitjen e materialit për vendimmarrjen për listën përfundimtare te pronave në Këshillin e Komunës, pasi kanë përfunduar faza e shpalljes dhe e ankimimit, nga momenti i dërgimit Ministria e Brendshme me shkresën me shkresën nr.6173/14, datë 13.05.2013 ka dërguar VKM nr. 194, datë 06.03.2013 “Për Miratimin e Listës Paraprake të Pronave të Paluajtshme Publike, Shtetërore, që Transferohen, në Pronësi ose në Përdorim të Komunës Shënkoll të Qarkut të Lezhë”.

-Për lejimin në vazhdimësi te përdorimit te paligjshëm e shfrytëzimi i pasurive truall në pronësi të kësaj Komune, prona të ish-Kooperativës Bujqësore dhe ish ndërmarrjeve, truallit për ndërtime shtëpi e përdorime ngrehinash kryesisht nga banorët, zaptim i truallit për kultivime bujqësore pa pasur marrëdhënie ligjore (pronësi a qiraje) lidhur me truallin, që ka sjellë si pasojë, përfitime të paligjshme qe përbejnë të ardhura të munguara për Buxhetin e Komunës për qera nga përdorimi i truallit për ndërtime të pa legalizuara dhe taksë toke bujqësore nga përdorimi i truallit për kultivime bujqësore.

-Nuk ka vazhduar përpjekja dhe puna bashkëpunuese me Ministrinë e Mjedisit për sigurimin e hartave përkatëse me kufijtë administrative të Komunës fqinjë të fondit pyjor dhe kullosor sipas kategorive të kaluar në listën e pronave nën juridiksionin e kësaj Komune.

**4. M.Gj.,** me detyrë **punonjëse personeli e protokolliste**, ne cilësinë dhe te anëtares te KVO, për këto shkelje:

- Ka lejuar emërimin e 2 policëve komunar, në kushtet e mungesës së formimit në Akademinë e Policisë, mungesës se kualifikimit tyre dhe moslidhjes se kontratës 3 vjecare, në kundërshtim urdhrin e përbashkët të Ministrisë Pushtetit Vendor dhe Ministrisë Rendit Publik nr. 1530, datë 7.4.2003 dhe nr. 823, datë 11.04.2003 dhe Rregulloren TIP dalë në zbatim të saj, me ligjin nr. 8224, datë 15.5.1997 *“Për Organizimin dhe Funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës”*, me ndryshimet e miratuara me nenin 7 te ligjit nr. 8335, datë 23.04.1998, neni 5, Rregulloren e brendshme *“TIP”* të policisë së Bashkisë dhe Komunës, të miratuar me urdhrin e përbashkët të dy Ministrive, neni 11 *“Përzgjedhja e kandidatëve, formimi dhe kualifikimi”*, pika 1.

-Për kualifikimin dhe shpalljen fitues te padrejte te operatorit ekonomik *“L...”* pa efekte financiare, ne kushtet kur subjekti rezulton debitore sipas shkresës nr. 185/5, date 24.10.2008 te KLSH-se, ne kundërshtim me kriteret e pranimit/kualifikimit ne tender, në kundërshtim me VKM nr.1 datë 10.01.2007 *“Për rregullat e prokurimit publik”*, i ndryshuar, Kreu VII, *“Kushte të përgjithshme për zbatim”*, pika 1, *“Mungesa e konkurrencës”*, germa *“a”* si dhe me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”* ndryshuar, neni 24/1.

**5. K.N.,** me detyrë **inspektor i ndihmës ekonomike**, për këto shkelje ligjore:

-Për anomali dhe pune te dobët ne kryerjen e detyrës.

-Për futjen dhe trajtimin me ndihme ekonomike ne mënyre të kundraligjshme per 6 raste, ne kushtet e mungesës te dokumentacionit, sipas dosjeve te audituara me zgjedhje nr.707, 708, 721, 735, 624 dhe 711.

-Për përfitim të paligjshëm të ndihmës ekonomike nga 6 familje për vlerën 123,000 lekë dem ekonomik, në kundërshtim me kërkesat e pikës 14, të VKM nr. 787, datë 14.12.2005 *“Për përcaktimin e kriterëve të procedurave dhe masës së ndihmës ekonomike”*.

**b. “Zbritje nga detyra per nje periudhe 1 vjecare”** bazuar ne nenin 10/d te kontratës individuale të punës për 3 punonjës, sa vijon:

**1. T.M.,** me detyrë **Përgjegjëse e Sektorit Financës**, si dhe ne cilësinë e anëtares njësisë së prokurimit, për këto shkelje ligjore:

-Për lejimin e shpenzimeve te pajustificuara për riparimin e 20 kompjuterave të Komunës, mbi kufirin ligjor 25 % të vlerës fillestare, konkretisht ne masën e vlerës fillestare tyre, dhe nen mungesën e saktësimin te viti blerjes dhe arsytet e difektimit si dhe mungesës procesverbalit te specialistit të fushës, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”* si dhe me udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”*.

-Për mangësi ne 6 raste ne blerjet e vogla pasi mungojnë specifikimet teknike, ne kundërshtim me udhëzimin e Agjencisë Prokurimit Publik nr. 02, datë 18.02.2008 *“Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”*.

-Për mos zhvillim tenderi ne 4 raste për vlerën 3,000,120 leke, por është proceduar me prokurim të drejtpërdrejtë duke copëzuar fondin me vlera nën 400 mijë lekë, për artikuj dhe shërbime ose grup shërbimesh të njëjta, brenda vitit kalendarik, në kundërshtim me nenin 28, 33 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”* ndryshuar, me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, me kreun II *“Rregullat e përgjithshme të prokurimit”* pika 1 *“Kufijtë monetarë”* shkronja B, me kreun IV shkronja C dhe me udhëzimin e Agjencisë Prokurimit Publik nr. 02, datë 18.02.2008 *“Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”* pika 4.

-Për shkelje ne 1 tender te pastrimit ne cilësinë e anëtares njësisë së prokurimit.



-Për zbatim të pjesshëm të detyrave të lëna me pare pasi nuk është arkëtuar vlera 2,407,850 leke për 4 subjekte juridike dhe 6 persona fizike, sipas shkresës nr.185/5, datë 24.10.2008 të KLSH, ku ka patur mundësi arkëtimi i disa prej tyre, pasi disa persona janë punonjës të komunës dhe 1 subjekt juridik ka marrëdhënie kontraktore me komunën, në kundërshtim me urdhërin nr.70, datë 18.4.2006 të Kryeministrit “Për zbatimin e rekomandimeve të Kontrollit Shtetit dhe Auditit Brendshëm” dhe me ligjin nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, me ndryshime në ligjin nr. 8599, datë 01.01.2000.

**2. P.P.**, me detyrë **kryeinspektor i INU** si dhe **në cilësinë e kryetarit të KVO**, për këto shkelje ligjore:

-Për punë të dobët në veprimtarinë e INUV për vitin 2011-2013.

-Për mos marrjen e masave për arkëtimin e 6 gjobave të vendosura për vitet 2011, 2012,2013, të cilat nuk janë arkëtuar për vlerën 2,100,000 lekë, veprim në kundërshtim me nenin 84 të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën” dhe me nenin 14 të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit”.

-Për mos dorëzim zyrtar të vendimeve të gjobave për vlerën 2,100,000 leke, në adresë të zyrës së financës me protokoll për kontabilizim.

-Për mos vendosje gjoba për të gjitha rastet e prishjes, pasi nga 40 vendime për prishje janë vendosur vetëm 6 gjoba dhe janë shmangur 34 gjoba, në kundërshtim me nenin 81 “Sanksionet” të ligjit “Për Urbanistikën” dhe pikën 8 të VKM nr. 862, datë 5.12.2007 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektoriat ndërtimor e urbanistik kombëtar e Vendor”.

-Për kualifikimin dhe shpalljen fitues të padrejte të operatorit ekonomik “Leka-2007” pa efekte financiare, në kushtet kur subjekti rezultoi debitor sipas shkresës nr. 185/5, datë 24.10.2008 të KLSH-se, në kundërshtim me kriteret e pranimit/kualifikimit në tender, në kundërshtim me VKM nr.1 datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu VII, “Kushte të përgjithshme për zbatim”, pika 1, “Mungesa e konkurrencës”, germa “a”.

**3. T.P.**, me detyrë **përgjegjës i taksave dhe tarifave vendore**, pasi:

-për mos arkëtimin e detyrimit në shumën 916,500 lekë të 11 subjekteve që ushtrojnë aktivitet të pa licencuara, dhe mos vendosjen e gjobave në masën 25.000 lekë, sipas nenit 112 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore”, dhe mos mbylljen e aktivitetit apo mos konfiskimin e materialeve në përputhje me ligjin nr. 9632, datë 31.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” dhe ligjin nr. 9920, datë 10.05.2008 “Për Procedurat Tatimore” neni 41.

-për arkëtimin e detyrimit në shumën 520,000 lekë të 9 subjekteve që ushtrojnë aktivitet sezonal në përdhën e verës dhe mos vendosjen e gjobës në masën 25.000 lekë, sipas nenit 112 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore”, mos mbylljen e aktivitetit apo mos konfiskimin e materialeve në përputhje me ligjin nr. 9632, datë 31.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” dhe ligjin nr. 9920, datë 10.05.2008 “Për Procedurat Tatimore” neni 41.

-për mos kallëzim penal për 19 subjektet të cilat nuk kanë paguar detyrimet për vlerën 4,505,500 lekë, në zbatim të nenit 131 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, i ndryshuar, pikës 130-132 të udhëzimit Ministrisë Financave nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe ligjit dhe Kodit Penal i R.SH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet neni 181, -Mospagimi i taksave dhe tatimeve.

-për mos dërgim zyrtar të detyrimeve fiskale me qëllim regjistrimin si debitorë, llogaritjen e kamat vonesave dhe ndjekjen ligjore të tyre.

- për mos vjeljen dhe arkëtimin e vlerës 178,000 leke mungese të ardhurash, që bënë fjalë për detyrime taksave vendore për vitin 2011 dhe 2012 ose 89,000 leke/vit, përkatësisht takse ndërtese 20,000 leke, tarife pastrimi 30,000 leke, takse tabelle 27,000 leke, tjera 12,000 leke, për

Kompaninë “A...”, në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

-për mos arkëtimin e vlerës 1,140,000 leke mungese te ardhurash, për subjektin P.Gj., qe bën fjale për mos arkëtim detyrime taksave vendore për vitin 2011,2012 dhe 2013, sipas shkresës se komunës Shënkoll nr.69/5, date 8.02,2013, për vlerësimin tatimor te 3 viteve drejtuar subjektit, në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

**c. “Zgjidhje të Kontratës së Punës”** bazuar ne nenin 144 te “Kodit Punës” për 5 punonjësit si me poshtë:

**1. L.C.**, me detyrë **Drejtor i Planifikimit të Territorit te Komunës** si dhe ne cilësinë e anëtares njësisë së prokurimit, për këto shkelje ligjore:

-Për shkelje të dispozitave ligjore me efekte financiare për vlerën 2,373,190 lekë dëm ekonomik ne 15 raste, për taksen e ndikimit infrastrukture dhe kamatëvonesa, në kundërshtim me nenin 51 paragrafi i dyte të ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” i ndryshuar dhe me piken 4 të vendimit nr. 84, datë 30.12.2010 ‘Për miratimin Taksave e Tarifave Vendore për 2011’ të Këshillit të Komunës.

-Për mos pasqyrim ne protokollin e KRRT te 5 lejeve të ndërtimit, në kundërshtim me nenin 40 te ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” i ndryshuar.

-Për dhenien e lejeve të ndërtimit në kushtet e mungesës se aktpronësive ne 2 raste, në kundërshtim me germën “e”, pika 2 të nenit 20, të ligjit nr. 8405 datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” i ndryshuar.

-Për shqyrtim dhe paraqitje për miratim në KRRT, dosje me mungesë dokumentacioni teknik dhe plotësimi e këtij dokumentacioni nuk është sipas kërkesave dhe afateve të përcaktuara, në kundërshtim me nenet 45 dhe 50, të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën”I ndryshuar.

-Për dhënie leje ndërtimi ne disa raste pa depozituar me pare dokumentin e pagesës se kësaj leje, në kundërshtim me nenin 51 të ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” i ndryshuar.

-Për mungesa te lejeve mjedisore ne disa raste, në kundërshtim me nenin 40 të ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” i ndryshuar.

-Për mos parregullsi ne formularin e zbardhjes së lejes së ndërtimit, për pasojë nuk pasqyrohen qartë afatet e zbardhjes së këtyre vendimeve, në kundërshtim me nenin 50, të ligjit nr 8405, datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën” i ndryshuar.

- Për shkelje ne 1 tender te pastrimit ne cilësinë e anëtares njësisë se prokurimit.

**2. F.D.**, me detyrë **teknik dhe supervizor i pastrimit** pranë sektorit shërbimeve te komunës, për këto shkelje ligjore:

-Për pa aftësi ne kryerjen e detyrës.

-Për mangësi ne 4 raste ne hartimin e dokumentacionit për sistemimin e riparimin e rrugëve te komunës ne vitin 2011-2013, përkatësisht mungon skica me përmasime, projekti, fotografimi ne vend, mungon dokumentacioni provues për dëmtimin e rrugës dhe lindjen e nevojës dhe justifikimin e shpenzimeve.

-Për konflikt interesi ne 1 rast, pasi ka marrë pjesë në hartimin e preventivit, ne mbikqyrjen e punimeve sipas kontratës date 25.3.2011 dhe date 15.4.2011 si dhe ne aktmarrjen në dorëzim date 5.4.2011 dhe date 18.4.2011, në kundërshtim me ligjin nr. 8402, date 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar.

-Për mangësi dhe parregullsi ne hartimin e preventivave dhe situacioneve ne 10 raste për shërbimet e kryera me vlera te vogla, konkretisht: Preventivat dhe situacionet nuk përshkruajnë zërat e punës ne sasi dhe çmim, por vetëm ne vlere etj.

-Për krijimin e demit ekonomik 830,680 leke, pasi është likuiduar tepër firma e pastrimit për periudhën kontraktore 2011 si rezultat i nënshkrimit të padrejtte të situacioneve të pastrimit nga supervizori, çka ka bere qe te likuidohet shuma 5,764,920 leke nga vlerën e kontratës 4,934,220 leke, ne kundërshtim me nenin 5 te kontratës pastrimit date 3.6.2011 dhe me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” si dhe me udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

-Për nënshkrimin e padrejtte të disa situacioneve të pastrimit për punime të pakryer ne vitin 2011, çka ka shkaktuar dem ekonomik për vlerën 830,680 lekë, në kundërshtim me kontratën e pastrimit date 3.6.2011 dhe me nenin 13 pika c te ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” si dhe me udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” si dhe me udhëzimin nr.2, date 6.02.2012 “Për procedurat standarte te zbatimit te buxhetit” pika 144, 147, 157.

-Për mosmbajtjen e dokumentave shoqëruese si procesverbale dhe relacione mujore të supervizorit, për kontrollin periodik të saktësisë së kryerjes së volumeve dhe cilësisë zërave të punimeve të pastrimit sipas situacioneve mujore, dokumente bazë këto për të pasqyruar punën e supervizorit, në kundërshtim me Rregulloren e brendshme të komune dhe me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

**3. P.Gj., me detyre përgjegjëse e ndihmës ekonomike, për këto shkelje ligjore:**

-Për anomali dhe pune të dobët ne kryerjen e detyrës.

-Për futjen dhe trajtimin me ndihme ekonomike ne mënyre të kundraligjshme për 6 raste, ne kushtet e mungesës te dokumentacionit, sipas dosjeve te audituara me zgjedhje nr.707, 708, 721, 735, 624 dhe 711.

-Për përfitim të paligjshëm të ndihmës ekonomike nga 6 familje për vlerën 123,000 lekë dem ekonomik, në kundërshtim me kërkesat e pikës 14, të VKM nr. 787, datë 14.12.2005 “Për përcaktimin e kriterëve të procedurave dhe masës së ndihmës ekonomike.

**4. B.P., me detyrë Përgjegjës i sektorit të shërbimeve dhe ne cilësinë e antarit të komisionit te blerjeve te vogla dhe magazinierit, për këto shkelje ligjore:**

-Për mungesë kontrolli ndaj vartësve te tij.

-Për miratimin dhe lejimin e disa parregullsive ne dokumentacionin e riparimit dhe sistemimit te rrugëve te komunës ne vitin 2011-2013.

-Për parregullsi te dokumentacionit ne 10 raste për shërbimet me vlera te vogla, pre mangësi ne 6 raste ne blerjet e vogla pasi mungoje specifikimet teknike, në kundërshtim me udhëzimin e Agjencisë Prokurimit Publik nr. 02, datë 18.02.2008 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”.

-Për mos zhvillim tenderi ne 4 raste për vlerën 3,000,120 leke, por është proceduar me prokurim të drejtpërdrejtë duke copëzuar fondin me vlera nën 400 mijë lekë, për artikuj dhe shërbime ose grup shërbimesh te njëjta, brenda vitit kalendarik, në kundërshtim me nenin 28, 33 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” ndryshuar, me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me kreun II ”Rregullat e përgjithshme të prokurimit” pika 1 “Kufijtë monetarë” shkronja B, me kreun IV shkronja C dhe me udhëzimin e Agjencisë Prokurimit Publik nr. 02, datë 18.02.2008 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla” pika 4.

-Për furnizimin me 772 litra karburant tepër nga normativat ligjore ne 3 raste, çka ka krijuar vlerën 135,872 lekë dem ekonomik, ne kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Komunës nr.75, date 30.12.2011 dhe nr. 47, date 27.12.2012, me UMF nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

-Për lejimin e pagesës së kundraligjshme për vlerën 400,000 lekë dem ekonomik, për shërbimin e pastrimit të plazhit nga një subjekt tjetër, kur pastrimi i plazhit mbulohet nga subjekti kontraktues, në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” .

**5. L.M., me detyrë inspektore e taksave dhe tarifave vendore,** për shkeljet e mëposhtme:

-Për paaftesi në kryerjen e detyre.

-për mos arkëtimin e detyrimit në shumën 916,500 lekë të 11 subjekteve që ushtrojnë aktivitet të pa licencuara dhe për mos arkëtimin e detyrimit në shumën 520,000 lekë të 9 subjekteve që ushtrojnë aktivitet sezonal në periudhën e verës.Për mos vendosjen e gjobave në masën 25.000 lekë, sipas nenit 112 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008”Për Procedurat tatimore” dhe mos mbylljen e aktivitetit apo mos konfiskimin e materialeve në përputhje me ligjin nr. 9632, datë 31.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” dhe ligjin nr. 9920, datë 10.05.2008 “Për Procedurat Tatimore” neni 41.

-për mos dërgim zyrtar të detyrimeve fiskale në dege e finance me qëllim regjistrimin si debitorë, llogaritjen e kamat vonesave dhe ndjekjen ligjore të tyre.

- për mos vjeljen dhe arkëtimin e vlerës 178,000 leke mungese të ardhurash, që bën fjale për detyrime taksave vendore pre vitin 2011 dhe 2012 ose 89,000 leke/vit, përkatësisht takse ndërtese 20,000 leke, tarife pastrimi 30,000 leke, takse table 27,000 leke, tjera 12,000 leke, për Kompanie “A..”, në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

-për mos arkëtimin e vlere 1,140,000 lekë mungesë të ardhurash, për subjektin Pashk Gjini, që bën fjale pre mos arkëtim detyrime taksave vendore për vitin 2011,2012 dhe 2013, sipas shkresës së komunës Shënkoll nr.69/5, date 8.02,2013, për vleresimin tatimor të 3 viteve drejtuar subjektit, në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

### **C. MASA ADMINISTRATIVE**

Mbështetur në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr.8599, datë 01.06.2000, bazuar në Vendimin e Këshillit Ministrave nr. 42, datë 16.1.2008 “ Për miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së Liçencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike,që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ndryshuar me VKM nr. 92, date 19.02.2014, Kreu VII, “Sanksione”,pika 1,shkronja (a), Pika I- Konstatohen ose provohen deklarime, të rreme, i rekomandojmë Komisionit të dhënies së Liçencave, pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, që për shkelje të ligjshmërisë në ndërtim të vendosë sanksionet si më poshtë:

- **Heqjen e Liçencës, për një afat prej 1 (një) viti, të dy mbikëqyrësve të punimeve të ndërtimit,** respektivisht:

**1. z. A.L.,** mbikëqyrës i punimeve me licence nr.MK 1687, lidhur kontrate date 5.11.2009, për periudhën nga data 05.11.2009 deri me datën 12.01.2010.

**2. z. R.K.,** mbikëqyrës i punimeve me licence nr.MK 1735/2), lidhur kontrate datë 3.7.2010, për periudhën nga data 03.07.2010 e në vazhdim.

Nga ana e Komunës Shënkoll për “Ndërtimin e Ujësjetës në fshatin Shenkoll” pas zhvillimit të procedurave të prokurimit, është lidhur kontrata datë 04.11.2009 me vlerë 33,701,561 lekë me tvsh dhe afat përfundimi prej 60 ditësh, me sipërmarrës punimesh “A.. Shkodër” sh.p.k.. Por edhe pse kanë kaluar mbi 4 vjet dhe janë bërë disa shtyre afati, deri në muajin Mars 2014, objekti ende nuk ka përfunduar, nuk është marë në doërzim dhe nuk është vënë në funksionim.

Ndërkohë që nga vlefata e kontraktuar prej 33,701,561 lekë me tvsh është likuiduar vlera 30,749,278 lekë, ose 91 % e saj, duke mbetur pa likuiduar vlera prej 2,952,283 lekë, nga e cila 1,618,382 lekë garanci punimesh dhe vlera 1,333,901 lekë, punime të pa likuiduara.

Për mos zbatimin e kontratës mban përgjegjësi firma zbatuese dhe për mos kontroll mbajnë përgjegjësi Autoriteti Kontraktor dhe veçanërisht 2 mbikëqyrësit e punimeve të cilët përveç mos mbajtjes së dokumentacionit të nevojshëm kanë raportuar dhe situacionuar 23 zëra punimesh të pakryera **duke shkaktuar një dëm ekonomik buxhetit të shtetit në vlerën 12,513,700 lekë pa tvsh**. Shkeljet në mënyrë të detajuara paraqiten më poshtë:

#### **1. Në dokumentacionin teknik të dosjeve të zbatimit të punimeve mungojnë:**

a-Grafiku i punimeve si për projektin e paraqitur për tender, dhe projektin e zbatimit.

b-Proçesverbale të punimeve të maskuara nuk janë plotësuar me saktësinë e duhur, pasi nuk përcaktojnë me korrektesë kordinatat, cilësinë e realizimit dhe volumet për çdo punim të maskuar të punimeve.

c -Materialet nuk janë të shoqëruara me çertifikata cilësie dhe nuk janë kryer raporte testimi që të vërtetojnë cilësinë e kërkuar të materialeve, kjo dhe për betonin e rezervuarëve.

d -Libreza e masave për përshkrimin e punimeve sipas grafikut dhe projekt zbatimit, nuk pasqyron punimet e kryera për të përcaktuar saktë volumet e punimeve dhe elementët e tjerë dhe të shoqëruar me skicat përkatëse, por është kopjo e situacionit.

Për këto shkelje shoqëria sipërmarrëse pretendon se është në proçes punimesh, dhe afati skadon më datën 30.06.2014.

#### **2. Dy mbikëqyrësit e punimeve, kanë nënshkruar situacionet për punime të pakryera për 24 zëra punimesh të cilat zënë 44 % e punimeve të kontraktuara (12.513: 28,084) për objektin “Ndërtimin e Ujësjellësit në fshatin Shenkoll” me sipërmarrës punimesh “A... Shkodër, për pasojë i është shkaktuar buxhetit të shtetit një dëm ekonomik në vlerën 12,513,700 lekë, pa tvsh.**

Shkeljet e mësipërme janë në kundërshtim me nenet 7,10 dhe 14, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar. Dhe pikat 4/d,9,10 dhe 17 të Udhëzimit KM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.

#### **D. KALLËZIM PENAL**

Bazuar në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 281, me shkresën nr. 1077/8, datë 31.3.2014 kemi bërë kallëzim penal duke dërguar për veprime të mëtejshme procedurale në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Lezhë:

*1-z. A.L., mbikëqyrës i punimeve me licence nr.MK 1687, lidhur kontrate date 5.11.2009, për periudhën nga data 05.11.2009 deri me datën 12.01.2010.*

*2-z. R.K., mbikëqyrës i punimeve me licence nr.MK 1735/2), lidhur kontrate datë 3.7.2010, për periudhën nga data 03.07.2010 e në vazhdim.*

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

*Shënim:* Auditimi është kryer nga audituesit Josif Lile, Përparim Gjuzi dhe Din Zeneli më tej u shqyrtua nga z. Niko Nako kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Luljeta Nano, Sekretar i Përgjithshëm.

## **KONTROLI I LARTË I SHTETIT**